



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE P. - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2022:059798

Datë: 02.06.2022

Numri i dokumentit: 03092068

**PPP.nr.193/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG**, si përmbartimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KRU H... SH.A me seli në P., kundër debitorit H.B.M me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 1,234.32 €, duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga ana e debitorit me dt. 30.10.2019, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbartimit, jashtë seancës me datën 02.06.2022, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit H.B.M me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, ashtu që **SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri mbi Lejimin e Përmbartimit P.nr.1220/2019, i dt: 08.10.2019, për periudhën kohore 14.10.2019 e gjerë më 15.04.2022, në shumë prej 757.27 €, si i parakohshëm.

**II. REFUZOHET** përtej pjesës së aprovuar si në pikën I të këtij dispozitivi prapësimi i debitorit H.B.M nga Istogu, ashtu që **OBLIGOHET** debitorit që kreditorit KRU H... SH.A me seli në P., në emër të borxhit për ujin e shpenzuar për periudhën kohore 01.01.2015 gjer me 15.10.2019, t'ia paguaje shumën prej 476.73 €, me kamat ligjore prej 8% nga pranimiti i këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Kreditori, KRU H... SH.A me seli në P., ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit H.B.M me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, në emër të borxhit për ujin e shpenzuar për periudhën kohore 01.01.2015 e gjer me 15.04.2022, në shumë totale prej 1,234.32 €, me kamat ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbartim të dt. 08.10.2019.

Përmbartuesi Privat me Urdhër P.nr.1220/2019, i dt: 08.10.2019, e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, H.B.M me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, me kërkesë që të aprovohet si i bazuar prapësimi, të prishet urdhri përmbartimor, me arsyetimin se gabimisht përmbartuesi e ka lejuar përmbartimin pasi që e njëjta kërkesë është parashtruar konform nenit 360 të LMD-së, po ashtu nuk mund të kërkohej borxhi i ardhshëm si është kërkuar me faturat e bashkangjitura.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe e mundësinë e paraqitjes së përgjigjes, por se në shkresë të lëndës nuk ka dëshmi që ka paraqit përgjigje në prapsim.

Gjykata Themelore në P. – Dega Istog, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohej përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave tjera të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë që të anulohet urdhri përmbartimor, me arsyetimin se nuk mund të kërkohej borxhi i ardhshëm si është kërkuar me faturat e bashkangjitura, të njëjtat pretendime gjykata i aprovoj pjesërisht si të bazuara pasi që i tërë borxhi që ngarkohet debitori për periudhën kohore 15.10.2019 e gjerë më 15.04.2022, në shumë prej 757.27 €, është borxh i parakohshëm pasi që borxhi mund të kërkohej vetëm pasi të bëhet i arritshëm për pagesë, e në rastin konkret përmbartuesi propozimin për përmbartim e ka lejuar me urdhër përmbartimor me dt. 08.10.2019, ku si fatura të arritura për pagës kanë qenë për periudhën kohore 01.01.2015 gjer me 15.09.2019, andaj gjykata vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi.

Kurse sa i përket pretendimeve rreth parashkrimit, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara pasi që kreditori me debitorin ka lidhur kontratë me nr. 2012016014 e dt. 15.08.2018 për pagesën e borxhit me 48 këste dhe kësti i fundit për pagës ka qenë data 15.04.2022, e konform nenit 368 të LMD-së kemi ndërprerje të rrjedhës së afatit të parashkrimit, ku nga ndërprerja e parashkrimit ka filluar të rrjedh afati i ri i parashkrimit në bazë të nenit 373 të LMD-së, kurse propozimin për përmbartim kreditori e ka parashtruar me dt. 08.10.2019, çka kemi përsëri ndërprerje të rrjedhës së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, par.1 dhe 2 të LMD-së.

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3, 17, 29 par.1.2, dhe par.3, 37, 38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbartimore), në lidhje me nenin 368 dhe 369, 373 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.193/2019 dt: 02.06.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.